



BASHKIA
KUKËS



Raporti PARAPRK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

RIKONSTRUKSION I RRUGES TOPOJAN



RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

RIKONSTRUKSIONI I RRUGES "TOPOJAN"

**VENDODHJA: RRUGA "Topojan", Njesia
Administrative Topojan , Bashkia Kukes, Qarku Kukes.**

Sipas ligjit Nr.10440, date 07.07.2011, "Per VNM", Shtojca 2, pika
10. B) Projekte per zhvillime urbane,

Investitor: BASHKIA KUKES

Hartoi raportin
DEDJA& SALILLARI" shpk

Ekspert VNM
Ing. Bashkim Salillari

Tirane, 2024

TABELA:

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR	6
2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHEM PROJEKTI	7
3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.....	10
4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.	20
5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.	24
6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.....	27
7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS .	27
8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.....	27
9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.	28
10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR.....	28

1. HYRJE

Ky raport paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te Bashkise Kukes per realizimin e projektit “Rikonstruksioni i rruges “TOPOJAN” .

Projekti është propozuar te realizohet me fonde te Bashkise Kukes, duke iu referuar rregullores së urbanistikes, si dhe të kontekstit urban, mjedisor e funksional të zonës.

Nderhyrjet ne kete rruge do te vijne si pasoje e amortizimit te saj, prej vitesh ne kete rruge nuk jane kryer investime, rruga eshte ne gjendje te keqe me gropa, me shtresa çakulli në gjendje jo të mirë të tabanit të saj, Objekti i ketij studimi eshte rikonstruksioni i rruges ekzistuese, duke bere te mundur sistemimin, asfaltimin e saj.

Topojani është një nga komunat më veri-lindore të Republikës së Shqipërisë në koordinatat gjeografike 41°59’30” në veri dhe 20°31’18” në Jug.



Ortofoto

2. Vendodhja

Objekti i cili do ti nënshtrohet procesit te rikonstruksionit si: sistemim, asfaltim eshte trupi i rrugës “TOPOJAN” ne njesin Administrative, Topojan, bashkia Kukes.

Topojani ka një relief të thyer kodrinor-malor , me male të larta të veshura, pllaja, bjeshkë dhe livadhe.

- në lindje kufizohet me komunën Shishtavec, me fshatrat Kollovoz, Shtreze, Novosej,
- në Jug kufizohet me komunën Grykë-Cajë dhe fshatin Buzmadhe ,
- në perëndim Mali i Gjalicës deri në Tërshenë, ndërsa

- në pjesën veriore kufizohet me komunën Zapod me fshatrat Oreshk,Orcikel.

Komuna Topojan i përket një zone të pasur ujore me shumë burime,të cilat në një relief kryesisht të thyer formojnë dhe Lumin e Topojanit, sic njihet nga vendasit (Reka e Topojanit).



Harta me Ndarjet e Njesive Administrative



Harta me zonat e banuara

Ne tabelën e mëposhtme janë pasqyruar koordinatat e segmentit të rrugës që do rikonstruohet
“TOPOJAN”, Njesia Administrative, Topojan.

KRGJSH			GAUS-KRUGER		
	X	Y		X	Y
1	542456.70	4650920.46	1	4459727.18	4651040.27
2	542510.18	4650894.70	2	4459780.36	4651013.89
3	542431.90	4650755.04	3	4459700.45	4650875.15
4	542447.86	4650722.14	4	4459716.03	4650842.07
5	542496.16	4650769.18	5	4459765.73	4650961.42
6	542500.92	4650696.38	6	4459768.78	4650815.69
7	542473.26	4650594.11	7	4459739.93	4650713.75
8	542561.18	4650582.63	8	4459827.71	4650701.24
9	542591.84	4650521.87	9	4459857.66	4650640.13
10	542645.88	4650513.75	10	4459911.60	4650631.38
11	542661.42	4650553.37	11	4459927.61	4650670.81
12	542736.88	4650491.77	12	4460002.34	4650608.33
13	542806.18	4650515.57	13	4460071.91	4650631.32
14	542890.41	4650503.79	14	4460156.00	4650618.56
15	542894.66	4650351.83	15	4460158.48	4650466.56
16	542988.46	4650319.63	16	4460251.90	4650433.27
17	543092.34	4650330.55	17	4460355.90	4650442.97
18	543128.18	4650229.47	18	4460390.55	4650341.48
19	543253.64	4650230.03	19	4460516.01	4650340.58
20	543232.63	4650086.95	20	4460493.33	4650197.75
21	543311.73	4649906.12	21	4460570.32	4650016.01
22	543334.73	4650032.87	22	4460594.80	4650142.48
23	543366.51	4650047.15	23	4460626.74	4650156.39
24	543414.25	4650146.97	24	4460675.64	4650255.65
25	543467.73	4650195.27	25	4460729.68	4650303.32
26	543630.22	4650338.55	26	4460893.84	4650444.69
27	543518.92	4650407.85	27	4460783.35	4650515.29
28	543488.82	4650527.55	28	4460754.65	4650635.33
29	543458.72	4650591.25	29	4460725.30	4650699.38
30	543525.92	4650593.35	30	4460792.52	4650700.70
31	543491.62	4650638.15	31	4460758.74	4650745.89
32	543487.42	4650772.55	32	4460756.11	4650880.33



Ortofoto



Harta topografike

3. Pershkrimi i Projektit

Infrastruktura Rrugore Ekzistuese

Traseja e rrugës ka gjerësi 3 – 3.5 m në disa vende dhe është në gjendje natyrore. Për shkak të kushteve të relievit dhe ndikimit të faktorëve atmosferikë rruga është e amortizuar.

“Rikonstruksioni i rrugës Topojan”, me gjatesi totale rreth 3.5 km, kanë gjeresi ekzistuese e cila varion nga 3 m deri në 3.5 m, si dhe përgjatë gjithë segmentit ekziston një kanal me gjerësi 30 cm duke sjelle karakteristika gjeometrike ne plan jo te rregullta dhe nuk është fare i aksesueshëm nga këmbësorët.

Rruga do të shërbejë ne te ardhmen dhe si bazë për vendosjen e rrjeteve ixhinierike (Kanalizimet e Ujrave të Zeza, Kanalizimet e Ujrave të Shiut, Rrjetit të Ujësjellësit, etj,)

Gjithashtu ndikimi i përrenjve të ndryshëm shpesh herë e bën këtë rrugë të vështirë për tu përdorur.

Investimi në shtrimin e kësaj rruge me shtresat e nevojshme sipas standarteve ,rikonstruksioni dhe vendosja e veprave të artit aty ku është e nevojshme për shkak të intervenimit të rrugës me kanale dhe përrenj, do e përmiresojnë cilësinë e jetës së banorëve të zonës. Gjithashtu është i domosdoshëm investimi në ndërtimin e saj pasi do të ketë një impakt në zhvillimin e turizmit malor në këtë zonë.

Pamje te gjendjes ekzistuese te segmenteve rrugore





Qëllimi i projektit.

Qëllimi i projektit është përmirësimi i infrastrukturës rrugore në këtë zonë e cila do ketë impakt të drejteperdrejtë në jetën e banorëve dhe në turizmin malor. Investimi i këtij objekti ka për qëllim ta shndërrojë rrugën në një hapësirë më të sigurt duke përmirësuar transportin dhe cilësisë së jetës së banorëve dhe përdoruesve të rrugës. Gjithashtu ne te ardhmen do te shërbejë dhe si bazë për vendosjen e rrjeteve ixhinierike (Kanalizimet e Ujrave të Zeza, Kanalizimet e Ujrave të Shiut, Rrjetit të Ujësjellësit, etj.)

Duke u mbështetur ne studimin per prespektiven e zhvillimit te zones, eshte dhene zgjidhje ne realizimin e nje rruge me gjeresi Variable te ndryshme duke variaur 9 m.

Kjo zgjidhje do kerkoje te behen zgjerime te rruges ekzistuese ne menyre qe te plotesohen parametrat e kerkuar.

Arsyet e realizimit te projektit janë të shumta po ndër to mund të përmendim:

- Rritjen e sigurisë në rrugë.
- Rritjen e cilësisë së lëvizjes dhe transportit.
- Zvogëlimin e kohës së levizjes në gjatësinë e kësaj rruge.
- Përmirësimin e jetesës së banorëve.
- Nxitjen turizmin malor duke nxitur kështu dhe përmirësimin e ekonomisë së zonës.

Përshkrimi i proceseve teknologjike të projektit

Proçeset teknologjike në këtë projekt janë ato të fazës ndërtimore, nëpërmjet punimeve të cilat do të kryhen nga firma ndërtuese. Disa prej proceseve kryesore të punimeve ndërtimore do të jenë: Piketimi i sheshit të propozuar për zhvillim; Vendosja e sinjalistikës dhe organizimi i kantierit; Pastrimi i sheshit nga mbetjet inerte; Punime gërmimi, mbushje, nivelimi për pershtatjen e trasese; Punimet e betonit dhe asfaltobetonit; Pastrimi i sheshit të ndërtimit në fazën përfundimtare; Sistemimi i shesheve dhe hapësirave të ndikuara në krah të infrastruktures; Rehabilitimi dhe risistemim i hapësirave të ndikuara, etj;

Treguesit e zhvillimit të projektit

“Rikonstrukcioni i rrugës Surroj”,

- me gjatësi totale rreth **3.5 km**,

Koncepti i propozuar për nderhyrje

Projekti është hartuar në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi siguron respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit janë parashikuar dhe respektuar të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji 107/2014 dhe VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

Rruga do të trajtohet sipas gjerësisë të trupit të rrugës të përcaktuar me një karrexhate një korsi 3 m, me bankina nga 50 cm në ane të rrugës me vendnderrime çdo 200-300 m.

Shtresat rrugore dhe të bankinave do të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri dhe do të përballojnë kapacitetet faktike dhe të prespektivës.

Shtresat Rrugore të dala nga llogaritjet dhe të diktuarat për të arritur nivelin mesatar të rrugës në lidhje me terrenin, do të jenë:

- Asfaltobeton - 4 cm
- Binder - 6 cm
- Stabilizant - 10 cm
- Çakëll makinerie - 20 cm

Ku shtresa e poshtme e çakëllit shërben dhe për profilim.

Gjatë realizimit të shtresave, do të respektohet cilësia e materialeve dhe kërkesat për kompaktësim, në përputhje me specifikimet teknike. Kanalet, do vendosen paralel me rrugën. (me këtë realizohet pjerrësia tërthore rrugës).

Gjithashtu në pika të veçanta, do të shihet mundësia e vendosjes së mureve mbajtëse dhe veprave të artit. Do të vendosen "guardrail" për shkak të terrenit.

Materialet që do të përdoren, do të jenë në përputhje me kushtet teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve.